

Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR

Mbi Pasqyrat Financiare te Riformuara dhe
Pasqyra e llogaritjeve te kapitalit
Per qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar

Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

Raport i dhënies së sigurisë i audituesit ligjor	I-III
Seksioni i pasqyrave të përlogaritjes me qëllim të rritjes së kapitalit	1-3
Shënime mbi pasqyrat financiare për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë	4-5
Aneksë të raportit	6



RAPORT I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR

Drejtuar:

ASAMBLESE SË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË
"BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A"

Qëllimi i Angazhimit:

Asambleja e aksionarëve të shoqërisë me vendim të datës 08.12.2023 na ka angazhuar si auditues ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave dhe mundësive të zmadhimit të kapitalit duke përdorur si burim kontributin e aksionarëve në likuiditete.

Kriteret

Si bazë për angazhimin e verifikimit të mundësisë për zmadhimin e kapitalit, ne kemi përdorur Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Ligjin Nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ne jemi njohur dhe kemi verifikuar edhe Vendimin e Asamblesë së shoqërisë për zmadhimin e kapitalit.

Ne jemi njohur dhe kemi verifikuar dokumentin e pranimit nga ana e aksionarëve për shumat e kontributit të pranuar gjatë fazës së parë dhe të dytë për qëllim të zmadhimit të kapitalit.

Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të Pasqyrave Financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të aksionereve dhe kryerjen e llogaritjes së drejtë të aksioneve që i takojnë aksionereve të shoqërisë në momentin e zmadhimit të kapitalit. Drejtimi është përgjegjës për respektimin e modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e asamblesë me rend dite zmadhimin e kapitalit.

Përgjegjësia jonë

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të përgatitura për këtë qëllim. **Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) "Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike"** dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale, si dhe financimet e kryera nga aksionarët mund të përdoren për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:

1. Verifikimin e përputhshmërisë së shifrave në Pasqyrën e Kapitaleve të Veta me ato të Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022.
2. Verifikimin e kontributit të pranuar nga aksionarët gjatë fazes së parë dhe të dytë të ofertimit për këtë qëllim deri më 29/12/2023.
3. Verifikimin e llogaritjeve për vlerën dhe numrin e aksioneve si efekt të zmadhimit të kapitalit themeltar.
4. Verifikimin e vendimeve të asamblesë së aksionarëve në lidhje me vendimmarrjet e tyre për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.
5. Të tjera çështje që vlerësohen të rëndësishme për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

Konkluzioni:

1. Bazuar në procedurat e kryera, shuma e kapitalit themeltar ekzistues deri më datën 08 dhjetor 2023 është 2,973,569,845 Lekë. Këto shuma rakordojnë me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam. Pasqyra Financiare e Kapitaleve të Veta, për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe shënimet e lidhura me to, japin një pasqyrim të sinqertë dhe të vërtetë të gjendjeve të Kapitaleve të Veta për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 si dhe lëvizjet në kapital themeltar deri më 29 dhjetor 2023.
2. Në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve datë 08 dhjetor 2023, vlera e synuar për zmadhimin e kapitalit që do të ishte 1,999,997,799 Lekë dhe numri i aksioneve të emetuar 1,164,042 aksione. Në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga menaxhimi i Bankës në këtë moment zmadhimi i kapitalit do të realizohet për shumën 1,695,845,204 Lekë dhe numri i aksioneve të emetuara do të jetë 987,019 aksione. Zmadhimi i kuotave do të bëhet deri në këtë masë. Pasqyra e llogaritjeve për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga menaxhimi i shoqërisë paraqet me vërtetësi vlerën nominale të aksioneve të emetuara prej 1,695,845,204 Lekë. Siç shprehet dhe në seksionin e pasqyrave të përlogaritjes me qëllim të rritjes së kapitalit, Banka, në përputhje me "Ligjin për titujt financiarë", nr. 9879, datë 21.02.2008 rezervon të drejtën për të ofruar aksionet e reja të panëshkruara investitorëve të mundshëm, me ofertë private.
3. Pasqyra e llogaritjeve për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga menaxhimi i shoqërisë paraqet me vërtetësi vlerën nominale të aksioneve në shumën 1,718.15 Lekë/aksion.
4. Në bazë të shkresave të dërguara nga aksionarët e shoqërisë (në aknekset bashkangjitur) pasqyra e llogaritjeve për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga menaxhimi i shoqërisë paraqet me vërtetësi numrin dhe vlerën e aksioneve të pranuar nga secili aksionar dhe respektivisht:

Aksionari	Nr. i aksioneve të pranuar	Vlera nominale e aksioneve Lekë
Eurosig sh.a.	987,019	1,695,845,204
Total	987,019	1,695,845,204

5. Në vijim të pagesës për kapitalin e ri të emetuar në bazë të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, kapitali i Bankës bëhet si më poshtë:

- a) Kapitali themeltar i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga 2,973,569,845 Lekë rritet edhe me 1,695,845,204 Lekë dhe bëhet 4,669,415,050 Lekë. Numri i aksioneve dhe vlera nominale për çdo aksion pas përfundimit të operacionit të rritjes së kapitalit do shkojë nga 1,730,682 aksione, rritet edhe me 987,019 dhe bëhet 2,717,701 aksione dhe vlera nominale mbetet e pandryshuar prej 1,718.15 Lekë/ aksion.
- b) Pas përfundimit të shit-blerjes së aksioneve nga aksionari Banka Islamike për Zhvillim (IsDB) tek aksionari ekzistues Eurosig sh.a si dhe operacionit të rritjes së kapitalit zotërimi i aksioneve në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë do të jetë si në vijim:

Aksionarët	Nr i aksioneve	Vlera Lekë	% e aksioneve	Vlera nominale per aksion Lekë
EUROSIG SH.A.	2,703,118	4,644,359,280	99.46%	1,718.15
Saudi Brothers Commercial Co.	3,168	5,443,097	0.12%	1,718.15
Hamed H. Mutabakani	9,306	15,989,096	0.34%	1,718.15
Hayder Mohamad Awad	1,267	2,176,895	0.05%	1,718.15
Faisal A. El Khereiiji	842	1,446,682	0.03%	1,718.15
Total	2,717,701	4,669,415,050	100.00%	1,718.15

Për shoqërinë Mazars shpk

29 dhjetor 2023

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

Seksioni i pasqyrave të përlogaritjes me qëllim të rritjes së kapitalit

Tabela 1. Struktura aksionare përpara rritjes së kapitalit është si më poshtë:

Struktura aksionare			
Leke	Numri i aksioneve	Kapitali aksionar	% e aksioneve
EUROSIG SH.A.	1,467,486	2,521,359,856	84.79%
Islamic Development Bank	248,613	427,154,220	14.37%
Saudi Brothers Commercial Co.	3,168	5,443,097	0.18%
Hamed H. Mutabakani	9,306	15,989,096	0.54%
Hayder Mohamad Awad	1,267	2,176,895	0.07%
Faisal A. El Khereiji	842	1,446,682	0.05%
Total	1,730,682	2,973,569,845	100.00%

Tabela 2. Pasqyra e përlogaritjes së numrit të aksioneve të cilat do të ofroheshin në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme më datë 08.12.2023 në mënyrë pro-rata .

Rritja e kapitalit	
Leke	Aksionet e reja të ofruara
EUROSIG SH.A.	987,019
Islamic Development Bank	167,215
Saudi Brothers Commercial Co.	2,131
Hamed H. Mutabakani	6,259
Hayder Mohamad Awad	852
Faisal A. El Khereiji	566
Total	1,164,042

Tabela 3. Më poshtë paraqitet pasqyra e aksioneve të ofruara aksionarëve ekzistues të bankës në mënyrë pro-rata.

Leke	Aksionet e reja të ofruara		Aksione të pranuar		Aksione të pranuar	
	Faza 1	Faza 2	Faza 1	Faza 2	Faza 1	Faza 2
	Aksionet e reja të ofruara	Aksione të pranuar	Aksione të pranuar	Aksionet e reja të ofruara	Aksione të pranuar	Aksione të reja për t'u emetuar të pranuar
EUROSIG SH.A.	987,019	-	987,019	-	-	987,019
Islamic Development Bank	167,215	-	-	167,215	-	-
Saudi Brothers Commercial Co.	2,131	-	-	2,131	-	-
Hamed H. Mutabakani	6,259	-	-	6,259	-	-
Hayder Mohamad Awad	852	-	-	852	-	-
Faisal A. El Khereiji	566	-	-	566	-	-
Total	1,164,042	177,023	987,019	177,023	-	987,019


Aksionari Eurosig sha ka ekzekutuar të drejtën për të blerë aksionet e reja të ofruara gjatë fazës së parë të ofertimit.

Me anë të vendimit të asamblesë së përgjithshme të mbajtur më datë 27.11.2023, miratohet shitja e aksioneve nga aksionari Banka Islamike për Zhvillim (IsDB) tek aksionari ekzistues Eurosig sh.a. si dhe në bazë të kontratës nr. Rep 6897 datë 21.12.2023 palët kanë rënë dakord me kushtet kontraktuale për shit-blerjen e aksioneve. Në bazë të sa më sipër dhe në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme më datë 08.12.2023 aksionari Islamic Development Bank ka shprehur synimin e saj për të mos marrë pjesë në këtë transaksion të rritjes së kapitalit dhe nuk do të ushtronte të drejtat e saj të parablerjes. Aksionarët e tjerë të minorancës nuk kanë shprehur interesin e tyre brenda 20 ditëve nga dita e publikimit të vendimit të asamblesë së përgjithshme më 08.12.2023.

mazars

Gjatë fazës së dytë të ofertimit, për aksionet e mbetura të papranuara në fazën e parë, aksionerët ekzistues nuk kanë shprehur interesin e tyre për blerjen e këtyre aksioeve.

Në përputhje me "Ligjin për titujt financiarë", nr. 9879, datë 21.02.2008 Banka rezervon të drejtën për të ofruar aksionet e reja të panëshkruara investitorëve të mundshëm, me ofertë private. Në rast se do të ketë interes nga investitorë të mundshëm, do të bëhet nje raport tjetër për të çertifikuar rritjen e re.


Orfea Dhuci
Drejtor i Përgjithshëm


Florjan Bizhga
Drejtor Finance



Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

Tabela 4. Pasqyra e Kapitaleve të Veta, për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe përcaktimit të vlerës nominale për aksion pas rritjes së kapitalit dhe përfundimit të shitjes së aksioneve nga IDB tek Eurosig sha.

Rritja e kapitalit		Aksione të reja per t'u emetuar te pranuara		Aksione te reja per aksion pas emetimit		Vlera nominale Vlera e aksioneve pas emetimit		% e pjesmarjes	
Leke	Numri i aksioneve	Kapitali aksionar	% e aksioneve	Numri i aksioneve pas emetimit	Vlera nominale per aksion	Vlera e aksioneve pas emetimit			
EUROSIG SH.A.	1,716,099	2,948,514,076	99.16%	2,703,118	1,718.15	4,644,359,280		99.46%	
Saudi Brothers Commercial Co.	3,168	5,443,097	0.18%	3,168	1,718.15	5,443,097		0.12%	
Hamed H. Mutabakani	9,306	15,989,096	0.54%	9,306	1,718.15	15,989,096		0.34%	
Hayder Mohamad Awad	1,267	2,176,895	0.07%	1,267	1,718.15	2,176,895		0.05%	
Faisal A. El Khreaji	842	1,446,682	0.05%	842	1,718.15	1,446,682		0.03%	
Total	1,730,682	2,973,569,845	100.00%	2,717,701	1,718.15	4,669,415,050		100.00%	

Me anë të vendimit të asamblesë së përgjithshme të mbajtur më datë 27.11.2023, miratohet shitja e aksioneve nga aksionari Banka Islamike për Zhvillim (ISDB) tek aksionari ekzistues Eurosig sh.a. si dhe në bazë të kontratës nr. Rep 6897 datë 21.12.2023 palët kanë rënë dakord me kushtet kontraktuale për shit-blerjen e aksioneve

Tabela 5. Pasqyra e Kapitaleve të Veta, për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë Për periudhën 31 dhjetor 2022 deri më 29 dhjetor 2023.

Përshkrimi (mijë lekë)	Shuma sipas PF 31.12.2022		Vlera nominale e aksioneve të reja qershor 2023		Vlera nominale e aksioneve të reja gusht 2023		Vlera nominale e aksioneve të reja dhjetor 2023		Shuma pas zmadhimit të kapitalit
	2,227,176	120,904	533,138	213,256	1,695,845	4,669,415	120,904		
Kapitali aksionar i paguar	2,227,176	120,904	533,138	213,256	1,695,845	4,669,415	120,904		
Rezervat									
Humbje të mbartura	(1,222,380)					(1,222,380)			
Totali i kapitaleve të veta	1,125,700	1,125,700	533,138	213,256	1,695,845	3,567,939	1,695,845	3,567,939	

Pasqyrat financiare për qëllim të zmadhimit të kapitalit janë hartuar dhe miratuar nga manaxhimi i shoqërisë dhe janë firmosur në emër të tij nga:



Orfea Dhuci
Orfea Dhuci
 Drejtor i Përgjithshëm

Florjan Bizhga
Florjan Bizhga
 Drejtor Finance

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (referuar më poshtë si "Banka" ose "UBA") është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin shqiptar. Bazuar në nenet e Statutit të saj, Banka ndjek Parimet Sharia. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike. Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Procedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994, data e themelimit. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licencën "Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë", në përputhje me Ligjin Nr. 8365, të datës 2 korrik 1998 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë"

Aktiviteti kryesor. Veprimtaria kryesore e biznesit të bankës është operacionet bankare tregtare brenda Republikës së Shqipërisë. Banka vepron nën një license të plotë bankare lëshuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Banka merr pjesë në skemën shtetërore të sigurimit të depozitave të administruara nga Agjensia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave.

Qendra e Bankës është vendosur në Tiranë. Aktualisht Banka ka një shpërndarje të aktivitetit në 4 degë në qytetet Tiranë, Shkodër, Fier dhe Durrës si dhe ka dy agjenci të vendosura në Tiranë. Zyra e regjistruar e Bankës është në rrugën Dritan Hoxha, ndërtesa nr. 11, Tiranë, Shqipëri.

2. Kapitallet e Veta dhe Zmadhimi i Kapitalit

Nisur nga nevoja për mbulimin e investimeve që po kryen, shoqëria ka targetuar që të injektojë kapital shtesë në shoqëri për shumën 1,999,997,799 Lekë. Ky vendim është marrë nga Asambleja e orktakëve të shoqërisë me vendimin e datës 8 dhjetor 2023. Përfundimisht u vendos që rritja e kapitalit të bëhet në masën 1,695,845,204 Lekë dhe numri i aksioneve të emetuara do të jetë 987,019 aksione

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a dëshiron që të rrisë kapitalin e saj aksionar me 1,695,845,204 Lekë, të ndara në 987,019 aksione të reja që do të emetohen , me një çmim emetimi për çdo aksion të barabartë me vlerën e tyre nominale, 1,718.15 për çdo aksion të ri, nëpërmjet ofertave private në përputhje me nenin 168, pika 1 dhe 4, 169, 171, 173, 174 seksioni 1, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Sipërmarrësit dhe Shoqëritë", ndryshuar (Ligji i Tregtisë) dhe nenet 27 e vijuese të ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt financiarë" (Ligji për titujt financiarë").

Bordi Drejtues i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë ka miratuar në parim rritjen e kapitalit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë Sh.a, me vendimin e mbajtur online në datë 08.12.2023.

Në bazë të nenit 174 seksioni. 1 të Ligjit të Tregtisë dhe të Statutit, aksionarët kanë të drejtë parablerjeje të aksioneve të sapoemtuara në përpjesëtim me kapitalin aksionar të regjistruar që përfaqëson aksionet në pronësi të tyre.

Të drejtat e parablerjes do të kryhen në disa faza:

i. gjatë fazës së parë aksionet e reja do t'u ofrohen aksionerëve ekzistues në bazë proporcionale, të cilëve do t'u jepet një periudhë 20 ditore nga data e publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të "Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme" të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë,që miratojnë rritjen e kapitalit;

ii. nëse në fazën e parë mbeten aksione të reja të panëshkruara nga aksionarët ekzistues, këto aksione do t'u riefrohen aksionerëve ekzistues që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes në kuadër të fazës së parë, në përpjesëtim me pjesën e tyre në kapital që rezulton nga faza e parë; këtyre aksionerëve do t'u jepet një periudhë shtesë prej 1 dite për të ushtruar të drejtën e parablerjes gjatë kësaj faze të dytë.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë

Nëse pas ushtrimit të procesit të parablerjes si më sipër, mbeten aksione të reja të panënshkruara, këto aksione do t'u ofrohen investitorëve të mundshëm, me ofertë private, në përputhje me "Ligjin për titujt financiarë", nr. 9879, datë 21.02.2008.

Shuma prej 1,695,845,204 Lekë, për aksionet e reja është paguar nga aksionerët nënshkrues për rritjen e kapitalit, brenda datës 29 dhjetor 2023.

3. Politikat Kontabël për pasqyrimin e Kapitaleve të Veta

a. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Ligjin Nr.25/2018 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

b. Monedha Funktionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase ALL (Lek), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e shoqërisë.

c. Humbje të Mbartura

Në këtë rubrikë pasqyrohet teprica e fitimit neto (humbje) i mbartur nga vitet paraardhëse.